



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

### V E N D I M K.P.P. 209/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.04.2019 shqyrtoi ankesat përkatësisht me:

**Objekt:**

“Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Murati-D” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-04974-01-24-2019, me objekt, “*Blerje material të ndryshme ndërtimi për mirëmbajtjen e rrugëve*”, me fond limit 4.124.600 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 04.02.2019, nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Bashkia Berat.”

**Ankimues:**

“Murati D” sh.p.k.  
Rruga e Kavajës, ish Kombinati Ushqimor, godina 1-katëshe,  
Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:**

Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Bashkia Berat  
Rruga “Baki Gjebrea”, Berat

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 25.01.2019, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-04974-01-24-2019, me objekt, “Blerje material të ndryshme ndërtimi për mirëmbajtjen e rrugëve”, me fond limit 4.124.600 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 04.02.2019, nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Bashkia Berat.

II.2. Në datën 04.02.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 11.02.2019 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Murati” sh.p.k.	2.994.760 lekë, skualifikuar
2. “Sark” sh.p.k.	3.729.800 lekë, skualifikuar
3. “Murati D” sh.p.k.	3.733.400 lekë, skualifikuar
4. “Beka” sh.p.k.	3.916.700 lekë, skualifikuar
5. “Euro-Alb” sh.p.k.	4.103.500 lekë, kualifikuar

II.4. Gjithashtu, nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), KPP konstaton se, autoriteti kontraktor në datë 22.02.2019 ka kryer ri-vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës, klasifikimi i të cilave është i njëjtë me atë të datës 11.02.2019.

II.5. Në datën 11.02.2019, operatori ekonomik “Murati D” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për vlerësimin e procedurës së prokurimit si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë për arsyet si më poshtë vijon:

*Anëtari 1 i KVO-së:*

- *Nuk ka xhiron vjetore te vitit 2018.*
- *Kandidati /ofertuesi nuk ka paraqitur per materialin tubo te brinjezuar deshmi te testimave zyrtare te kryera, te leshuara nga institucione te autorizuar ose nga prodhuesi qe vertetojne pajtueshmerin e materialeve te prodhuara me standartet e kerkuara.*
- *Ka kontrata te ngjashme furnizimi me objektin e prokuruar por shumta e materialeve te ngjashme nuk kalon vleren 40 % te fondit limit.*
- *Operatori ekonomik nuk ka linje prodhimi dhe perpunimi te inerteve dhe asfalto beton nuk ka licensat e nevojshme dhe nuk ka kontrat furnizimi per material inerteve me nje operator te licensuar, te lidhurave para noterit shoqeruar me dokumentacionin ligjor te linjes se prodhimit dhe perpunimit te inerteve dhe asfalto beton me afat deri ne perfundimin e kontrates.*
- *Operatori ekonomik nuk ka paraqitur flete analize te leshuar nga nje laborator i certifikuar nga organet kopetente te shtetit shqiptar.*

*Anëtari 2 i KVO-së:*

- *Mungon deklarimi i xhiros vjerore per vitin 2018.*
- *Mungon testimi zyrtar per tubat e brinjezuar HDP.*
- *Mungojne kontratat e furnizimit per inertet dhe asfaltobetonin.*
- *Ekziston nje kontrate furnizimi i operatorit me Bashkine Roskovec por nuk arrin te plotesoje fondin 40% te fondit limit me mallra te ngjashem me ato te prokurimit.*
- *Mungon autorizimi i prodhuesit per tubat e brinjezuar.*
- *Mungojne deshmita per furnizime te ngjashme te operatorit, kontrata me Bashkine Roskovec nuk eshte per mallra te ngjashem me ato te prokurimit.*

*Anëtari 3 i KVO-së:*

- *NUK ka deklarim te xhiros se vitit 2018.*
- *Nuk ka deshmi te testimave te kryera per materialin tubo te brinjezuar.*
- *Nuk ka kontrata furnizimi per inertet dhe asfaltobetonin.*

- *Kontrata e lidhur me Bashkine Roskovec nuk eshte per mallra te ngjashme me objektin e prokurimit, pasi vlera ne total e mallrave te ngjashme(zhavor, cimento dhe hekur) nuk e kalon vleren prej 40% te fondit limit te parashikuar ne dokumentet e procedures, por arrin vetem ne 12% te vleres se fondit limit.*
- *Mungon autorizimi i prodhuesit per tubat e brinjezuar.*
- *Kontrata e lidhur me Bashkine Roskovec nuk eshte per mallra te ngjashem me objektin e prokurimit*

II.6. Operatori ekonomik “Murati D” sh.p.k. në datën 15.02.2019 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar arsyet e skualifikimit e ofertës së tij ekonomike në procedurën e mësipërme të prokurimit. Konkretisht operatori ekonomik ankimes pretendon si më poshtë vijon:

*[...]I nderuar drejtor po ju drejtohem pasi sipas kerkesave kualifikuese dhe vleresimit te KVO te vendosur nga ju kemi nje mosperputhje te plote te cilat kane shkelur rregullat e konkurimit te LPP. Te cilat do i sqarojme si me poshte:*

*1-Ne kerkesat kualifikuese ne piken 2.2.2 kerkohet xhiro e tre viteve 2016, 2017,2018 ku kjo xhiro te mos jete me e vogel se 4.124.600. Sipas LPP thuhet se kjo xhiro ne mesataren e tre viteve te mos jete me e vogel se 4.124.600 leke ku xhiro e dy viteve 16, 17 eshte shumefish i kerkeses suaj dhe jo aq sa kerkohet. Pra vetem duke u nisur nga ky fakt ne ska perse skualifikohemi.*

*2-Theksojme se xhiro e vitit 2018 del pas mbylljes se bilancit per te cilen kemi afat deri me 31.03.2019 pra dhe si kerkese eshte e kundra ligjshme por theksojme se kontrata me Bashkine Roskovec ka nje vlere 6.800.000 leke qe eshte realizuar ne vitin 2018 kete e deshmojne faturat e shitjes se tij instucioni pra xhiro e vitit 2018 eshte tejkualuar vetem me kete deshmi te saj fature me nr serie 56604728 me numer fature 728 me date 27/02/2018. E theksoj se vetem kjo fature deshmon nje pjese te xhiros 2018 qe eshte aktualisht 125% me e larte se ajo qe kerkoni juve ne DST. Pra pika e mungeses se xhiros 2018 nuk ekziston per dy arsyet e shpjeguara.*

*2-Thuhet se nuk eshte plotesuar pika 2.3.1 - OE duhet te paraqese kontrata te ngjashme. E theksoj kontrata te ngjajshme - Ne kontraten e paraqitur ne tender per kualifikim permban plotesisht kerkesen e kerkuar pasi ka fund e krye material ndertimi ka te gjithë tubat e kerkuara duke perfshire dhe tub korrogate mgjth kjo nuk duhet te thote se per ne kontrate nuk ka asphalt beton qe futet ne grupin e materialeve te ndertimit pasi dhe vete titulli i objektit eshte "Blerje materiale te ndryshme ndertimi per mirmbajtjen e rrugeve" dhe jo blerje asfalbeton. Keshtu dhe kete pike ne e plotesojme plotesish sipas kerkesave te kerkuara nga ju dhe ne perputhje me LPP. Keshtu sipas LPP pika 2.3.1 eshte plotesuar 400% e jo vete aq sa kerkohet.*

*3-Thuhet nga kvo se mungon kontrata me prodhuesit e asfaltobeton dhe inerte që per ne pika 2.3.6 qe thuhet konkretisht; “Operatori ekonomik qe ka linje prodhimi dhe perpunimi te inerteve dhe asfalto beton duhet te kete licensat e nevojshme ose kontrat funizimi per material inerteve me nje operator te licensuar, te lidhur para noterit shoqeruar me dokumentacionin ligjor te linjes se prodhimit dhe perpunimit te inerteve dhe asfalto beton me afat deri ne perfundimin e kontrates. Operatori ekonomik duhet te paraqesi flete analize te leshuar nga nje laborator I certifikuar nga organet kompetente te shtetit shqiptar”. Sa e lexoj une kete kerkese kjo nuk ben fjale per ne qe jemi tregtare te ketyre mallrave por ben fjale per operatorin qe ka linje prodhimi dhe perpunimi inerti e asfaltbetoni dhe nuk ben fjale per neve prandaj KVO nuk ka te drejte te me skualifikoje sepse ne nuk jemi as prodhues as perpunues te inerteve. Prandaj dhe kjo pike per mua bie poshte.*

*Mungon autorizimi i prodhuesit per tuba korrogate - Edhe kjo nuk qedron se ne kemi paraqitur autorizimin e firmes: "FRUTIBEST" sh.p.k. qe prodhon te gjitha llojet e tubave e shprehur kjo ne ISO ne KATALOG qe verteton dhe cilesine e mallit.*

*Mungojne detyrimet vendore -Kjo pike nuk ekziston pasi ato shprehen ne dokumentat e paraqitura ne tender me emrin d2 ne oren 15.37 min dhe dok -taksat bashkiake per vitin 2018-ne oren 15.33 min. Pra nuk e kuptoj se cfare ka verifikuar ky KVO.*

*Perfundimisht pretendimet e kvo i nderuar drejtor ne baze te LPP nuk qendrojne prandaj ju lutemi te ballafaqohi konkretisht dhe oferta jone te rivleresoher e kualifikuar. Perfundimisht kerkojme:*

*1-Rivleresimin e ofertave pasi ato jane radhitur ne kundershkrim te ligjes se konkurimit jane manipuluar shifrat e realitetit te konkurimit dhe radhitja e tyre eshte e pa rregullt dhe jasht ligjes.*

*2-Kerkojme sqarime se perse jemi skualifikuar pra cilat jane kriteret dhe specififikimet qe shogeria jone nuk ka plotesuar ne kete konkurim.*

*3-Kerkojme qe shogeria jone te kualifikohet pasi i ploteson te gjitha kerkesat kualifikuese te percaktuara ne DST.*

*Deshiroj qe kete ankese ta mbyllim ketu pa qene nevoja per ta derguar me lart sepse ketu eshte vetem ceshtje interpretimi te problemit qe dhe Vnuk eshte thelluar sa e si duhet ne kete drejtim. E them kete pasi e kemi biseduar problemin ne fjale me specialist e kompetent te saj fushe dhe para se te paraqitshim oferten.*

II.7. Referuar ankesës së operatorit ekonomik ankimues si dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj, ky i fundit sqaron se në datë 20.02.2019 ka marrë dijëni në lidhje me kthimin e përgjigjes së autoritetit kontraktor me anë të email-it, ku ankesa e tij pranohet pjesërisht. Ndërkohë që referuar informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë KPP nga autoriteti kontraktor, ky i fundit në datën 19.02.2019, me anë të shkresës nr.116 prot., i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimues duke e pranuar pjesërisht atë. Ndër të tjera, autoriteti kontraktor, në dokumentacionin e dorëzuar pranë KPP, ndër të tjera ka bashkëlidhur rocesverbalin nr.7 datë 19.02.2019 të mbajtur nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Murati D” sh.p.k. ku argumenton:

*“[...] KVO ka refuzuar oferten duke u justifikuar ne mungesen e dokumentacionit si me poshte:*

*a. Mungon deklarimi i xhiros vjetore per vitin 2018*

*b. Mungon autorizimi i prodhuesit per tubat e brinjezuar*

*c. Mungojne kontratat e furnizimit per inerte dhe asfaltobetonin*

*d. Mungojne deshmite per furnizime te ngjashme te operatorit*

*1. Operatori ekonomik Murati D shpk nuk i ka dorezuar disa nga dokumentat e mesiperme si meposhte*

*1.1 Mungon vertetim i xhiros 2018 i cili eshte nje vertetim i cili leshohet nga Drejtoria e Tatimeve, pasi faturat tatimore deklarohen online cdo muaj ne sistemin elektronik.*

*1.2 Mungon dhe deshmi te testimeve zyrtare te kryera, te leshuara nga institucione te autorizuar ose nga prodhues qe vërtetojnë pajtueshmerin e materialeve te prodhuara me standartet e kerkuara per tubo brinjezuar.*

*1.3 Mungojne kontratat e furnizimit per inerte dhe asfaltobetonin, si dhe fletet e analizave te inerteve.*

*Sipas pikes 2.3.6 Operatori ekonomik qe ka linje prodhimi dhe perpunimi te inerteve dhe asfalto beton duhet te kete licensat e nevojshme ose kontrate funizimi per material Inerteve me nje*



operator te licensuar, te lidhura para noterit shoqeruar me dokumentacionin ligjor të linjës së prodhimit dhe përpunimit të inerteve dhe asfalto beton me afat deri ne perfundimin e kontrates. Operatori ekonomik duhet te paraqesi flete analize te leshuar nga nje laborator i certifikuar nga organet kopetente te shtetit shqiptar.

Pika 2.3.6 nje kriter I vendosur nga Komisioni i prokurimit ka si qellim qe prodhuesit ose tregtuesit te cilet e sigurojne furnizimin me inerte ma ane te kontrates kane lejet mjedisore te nevojshme (QKL) te cilat nuk e marrin inertin ose e perpunojne ne menyre te jashte ligjshme duke ndotur dhe demtuar mjedisin. Firma Murati D shpk ka QKL Leje mjedisore e te tipit C per aktivitetin: Magazinimi i Kimikateve. E cila nuk garanton qe furnizimi me inerte dhe asfaltobeton do te behet brenda kuadrit ligjor. Firma Murati D shpk nuk ka QKL leje mjedisore per prodhimin e inerteve dhe asfalto betonit si dhe nuk ka nje kontrate furnizimi me ndonje kompani qe disponon QKL lejet mjedisore. Gjithashtu operatori ekonomik Murati D shpk nuk ka dorezuar fletet e analizava qe te garantoj cilesin e inerteve qe do te furnizoj.

2. Gjithashtu nga komisioni i shqyrtimit të ankesave ka konstatuar se operatori ekonomik Murati D shpk i ka dorëzuar disa nga dukumentat dhe eshte vlersuar gabim nga KVO si meposhte:

2.1 Autorizimi i prodhuesit per tuba e brinjzuar. Nje dokument i ngarkuar me emrin deklarate\_bera\_NSHP(456.3 kb) ngarkuar ne sisten ne 4.2.2019 08:55.

2.2 Deshmite per furnizime te ngjashme te operatorit, Operatori ekonomik e ka vertetuar me nje dokument te ngarkuar ne sistem FATURA\_BASHKIA\_ROSKOVEC (755.2kB) 3.2.2019 15:42. Me ane te kesaj fature operatori ekonomik verteton se ka realizuar furnizime te ngjashme ne këtë fature janë materiale të ngjashme të cilat kërkohen edhe nga autoriteti kontraktor te tilla si hekur, cemento, zhavorr. Por shuma e këtyre materialeve te ngjashme nuk e kalon vlerën 40 % te fondit limit.

2.3 Detyrimet vendore eshte nje dokument i ngarkuar ne sistem nga operatori ekonomik me emrin TAKSA\_BASHKEI\_2018 (79.1 KB) 3.2.19 15:33 ne te cilin verteton qe ka paguar taksat vendore per vitin 2018. Eshte vleresuar gabim vetem nga nje anetar i KVO.

Pas shqyrtimit te dokumentave te mesiperme komisioni i shqyrtimit te ankesave doli ne perfundimin se vleresimi i ofertave nga KVO është kryer pjeserisht i sakte.

Komisioni i shqyrtimit te ankesave pranon pjeserisht ankesen e operatori ekonomik MURATI D shpk dhe e dergon per rivleresim tek KVO. [...]

II.8. Në datën 25.02.2019 operatori ekonomik “Murati D” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke pretenduar si më poshtë vijon:

[...]1-Ne rivleresimin e bere KVO ka pranuar ndryshe nga vleresimi i pare i dates 11.02.2019 vetem faktin e autorizimit te prodhuesit dhe pagesen e taksave bashkiake qe perpara ankeses sone KVO nuk i kishte pare dhe me rivleresim ata i pranuan kurse te gjitha pretendimet tjera qe perbenin ankesen tone perseri nuk i kishin shikuar.

Ne kerkesen kualifikikuese kerkohet

2.2.2 Operatori/et Ekonomik duhet te paraqes/in kopje te deklarimit te xhiros vjetore per tre vitet e fundit ushtrimore (2016-2017-2018) nga autoritetet perkates. Vlera mesatare e se ciles duhet te jete jo me e vogel se vlera e fondi limit perkatesisht: 4.124.600. Duke unisur nga ky kriter KVO: "thekson se mungon xhiro e vitit 2018" une ne ankese i pergjigjem se ne kriterin teknik 2.2.2 kerkohet qe shoqeria per 2016; 2017; dhe 2018 xhiro duhet te jete jo me e vogel se 4.124.600 leke. Xhiro per keto vite eshte 10 here me e madhe se sa kerkohet kurse xhiro e vitit 2018 del pas dates

31 mars 2019 megjithate ne dokumentat e tenderit kemi pasqyruar nje kontrate te ngjajshme me vlere 6.820.000 leke pa tvsh qe te pakten vetem kjo kontrate verteton 1.5 here me shume se kerkoni ju. Prandaj mendoj se kerkesa juaj e xhiros mesatare per tre vitet 2016, 2017 dhe 2018 shkon shume here se sa kerkohet. Por Drejtori nuk e mori ne konsiderate as xhirot 2016, 2017 me mbi 35 milion leke te reja si dhe kontraten e 2018 me vleren 6.820.000 leke. Mendoj se ky kriter eshte plotesuar me se miri megjithe kerkesa mbi LPP.

Se treti: Kvo thekson se mungon kontrata e ngjajshme pasi kontrata me bashkine Roskovec prej 6.820.000 leke ne listen e tij preventive nuk ka asfalt beton. Ne beme pyetjen po asfalt beton nuk ben pjese ne materiale ndertimi por ato ngulin kembe qe kontrata duhet te kete pa tjetër asfaltbeton per tu kualifikuar si kontrate e ngjajshme. Kete logjike te drejtorit e te KVO nuk e kuptoj pasi eshte ne kundërshtim me ligjen e prokurimit. Aq me teper se ne kete kontrate nuk kemi vetem asfalt beton por

Nr.	Lloji i punimit	Njesia	Sasia
1	Çimento 32.5 R	kg	80000
2	Zgara hekuri Ø6 (5x2) m	cope	291
3	Bitum M- 3 leng	kg	100
4	Asfaltobeton guri kave	ton	50
5	Zhavor lumi	m <sup>3</sup>	620
6	Derras 5*4	m <sup>3</sup>	3
7	Gozhde	kg	100
8	Boje akrilike	litra	300
9	Dylen	litra	100
10	Çakell mbeturine per mbushje	m <sup>3</sup>	2000
11	Kapak pusete (45x70)	cope	11
12	Tube te brinjezuar HDPE d= 500 mm	ml	18
13	Pllaka betoni 30 x 30 x 5	m <sup>2</sup>	282

dhe te gjithë keto artikuj ku jane ne nje peshe me te larte ne vlere se sa 50 ton asfalt beton. Akoma me tutje kvo thekson se nuk plotesohet 40 % i kontrates se ngjajshme. Ndalemi konkretisht ne artikujt dhe vlerat perkatese te disa prej tyre. Nga kontrata vecojme disa artikuj: 1- hekur dhe llamarine - 674.000 leke + 2-rere dhe zhavor plotesojn vetem 2% te kontrates se ngjajshme duke lene jasht inerteve si reren po kjo nuk eshte inerte i pyesim KVO ku vetem ky artikull ne kontraten e realizuar kap vleren -1.263.000 ku ne skualifikim Kvo thote se inertet si cemento dhe +4 - cemento 194 600 leke + 5-tubo korrogate e tuba te dimensioneve te ndryshme 1.615.020 leke = 3.941.220 leke pa perfshire artikuj te tjere te kontrates ku dhe keto jane materiale hidraulike. Pra si mund te thuhet se nuk ka kontrate te mjaftueshme te ngjajshme ku aty ka me shume se 100% e kerkeses se kerkuar si te tille. Kjo ndodh vetem se ne kontrate nuk ka artikullin asphalt beton e bitum. Prandaj ky fakt hedh poshte pretendimin e kvo qe thekson se KVO."se mungojne kontratat e furnizimit per inerte dhe asfalt beton ekzistojne kontrate me Roskovecin-vazhdon kvo-por nuk e ploteson 40%" a e kuptoni se cthuhet ku e ploteson afer vetem inernet pa hekur pa cemento etj. Kjo eshte e verteta e kontrates se ngjajshme ku ne nepermjet kontrates se realizuar ne kemi te pakten 200% kontrate te ngjajshme. Kete fakt do jua pasqyrojme ne kontraten qe do ju sjellim konkretisht ne dosjen e ankeses. Por per te arritur ne OE qe shprehte vleren maksimale 4.103.500 leke nga 4.124.600 leke

qe ishte vlere e tenderit duke u ulur nga prokurimi vetem me 21.100 leke shikohet si oferta me e sukseshme ku oferta jone eshte me 3733.400 leke ose me e ulet me 373.310 leke ose rreth 9% me e ulet se konkruesi dhe 10 % nga oferta e AK.

4- Mungon testimi zyrtar i tubit: Thekson KVO-Interpertojme kerkesen kualifikues per kete kërkesë. Kerkesa kualifikuese

2.3.2 Operatori/et Ekonomik duhet te paraqes/in Certifikata ISO ose ekuivalente per objektin e prokurimit.

Operatori/et Ekonomik ofertues duhet te dorezoj/ne deshmi qe garantojne autoritetin kontraktor se malli i ofruar eshte prodhuar nga kompani te certifikuara sipas standardit ISO 9001:2008/2015. Per kete, ofertuesi/it duhet te dorezojne certifikaten ISO 9001:2008/2015 ose ekuivalente te prodhuesit. Nisur nga ky kusht shoqeria ka dorezuar CERTIFIKATAT ISO 9001-2015 ku plotesohet kerkesa e kerkuar.

2.3.4 Kandidati /ofertuesi duet te paragese autorizim prodhuesi per materialin tubo te brinjezuar, certifikat ISO 9001:2008/2015 ose ekuivalente te prodhuesit dhe deshmi te testimave zyrtare te kryera, te leshuara nga institucione te autorizuar ose nga prodhuesi qe vertetojne pajtueshmerine e materialeve te prodhuara me standartet e kerkuara. Keshtu sipas kerkeses se mesiperme ne kemi dorezuar I-Autorzimin e prodhuesit si dhe Certifikatën e cilesise 9001-20015 si dhe katalogun perkates qe permban deshmi te tubit te kerkuar nga kompania - FRUTIBEST-shpk qe thekson ose nga autoritetet e autorizuar ose nga prodhuesi ne i kemi afruar testimet e prodhuesit. Kjo eshte dhe argument i testimi zyrtar i tubave qe kerkojne AK. Per kete do ju dergojme dhe kalogun dhe certifikaten ISO te shoqerise per ti pare nga afer. Theksojme se artikulli tuba sipas preventivit-tub te brinjezuar HDPE d= 500mm gjithesej 18 ml x5000 leke/ml =90.000 leke me TVSH vlere kjo e 1e 41 e vleres totale te vleres se tenderit. Nenkuptohen kerkesa kaq te shumta vetem per kete vlere vetem e vetem per te skualifikuar firmat. Ku mund ti kerkosh e ti sjellesh mostren qe don vete AK. Por gjithë keto kerkesa kane vetem nje emerues qellimi per te kapur shoqeri qe nuk e plotesojn kete kriter per te arrit finale.

Pretendimi i KVO vazhdojne i referohemi si me poshte: -OE-thuhet-nuk ka linje prodhimi perpunim te inerteve dhe asfaltbetoni nuk ka licensat e nevojshme dhe nuk ka kontrate me nje prodhues qe disponon te gjitha licensat te lidhur para noterit me afate deri ne perfundim te kontrates apo kontrate furnizimi me asfalt beton dhe linje te inerteve. OE-vazhdon KVO-nuk ka sjellur flete analiza perkatese nga nje laborator i licensuar ne Shqiperi-ky eshte pretendimi i KVO sqarojme se per kete pike ne kriteret kualifikuese thuhet-ne pike: Keto pretendime jan te lidhura me piken 2.3.6 kerkesa kualifikuese e citojme: 2.3.6 "Operatori ekonomik qe ka linje prodhimi dhe perpunimi te inerteve dhe asfalto beton duhet te kete licensat e nevojshme ose kontrate funizimi per material inerteve me nje operator te licensuar, të lidhura para noterit shoqeruar me dokumentacionin ligjor te linjes se prodhimit dhe perpunimit te inerteve dhe asfalto beton me afat deri ne perfundimin e kontrates. Operatori ekonomik duhet te paraqesi flete analize te leshuar nga nje laborator i certifikuar nga organet kompetente te shtetit shqiptar." Perfundon kriteri. Sic shikohet kerkesa e mesiperme nuk na takon neve se nuk jemi prodhues apo perpunues ne jemi tregtar dhe kjo kerkesa nuk na perket ne sepse sipas kriterit te cilesuar me siper kriteri 2.3.6 eshte kriter vetem per prodhuesin nenkuptohet se ne nuk na eshte kerkuar flete analize nga labaratoret. Kete kerkesa kualifikuese kerkojne qe ta kerkojn edhe nga operatori yne pra dhe kjo pike nuk egziston per shoqerin tone kjo eshte kerkuar vetem prodhuesit. Sa sipër shikohet se qëllimi I AK është plotësisht I qëllimshëm për të kërkuar jashtë atyre të kërkuara në DST.



Ankesen e kemi bere ne perputhje te plote me LPP shpallja e fituesit eshte bere me 11.02.2019 dhe ne e kemi nisur ankesen me date 15/02/19 dhe AK kemi marre vetem nje e-mail me date 20.02.2019 ne oren 1 e 50 min PM. Shoqeria jone priti nje pergjigje nga Drejtori deri me date 24.02.2019 dhe duke u nisur nga afatet permos marrje pergjigje ju drejtuam juve KPP me kete ankese pasi sot permbushen plote dhjete dite nga afati i marrjes se ankeses. Meqenese ne nuk morem asnje pergjigje deri ne keto momente ne i drejtohem KPP me arsyen se kemi plotesisht te drejten e ligjshme per te fituar keto furnizime ne Ndermarrien e Sherbimeve Publike Berat.

Ne kerkojmë të kualifikohet shoqëria jonë në këtë prokurim pasi plotësojmë të gjitha kërkesat kualifikuese të DST të AK. Dhe të mbahet qëndrim ndaj personave që me dashje për të kaluar në ofertën limituese të fondit na sorollasin na humbin kohë etj.

II.9. Njëpërmjet shkresës nr. 148/1 prot., datë 05.03.2019, protokolluar me tonën në datën 06.03.2019, me objekt “Dërgim informacioni dhe dokumentacioni për procedurën e prokurimit publik” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Murati D” sh.p.k. se arsyeja e skualifikimit të ofertës së tij ekonomike “...Nuk ka kontrata furnizimi per inertet dhe asfaltobetonin” nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.6 e “Kapacitetit teknik”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

“Operatori ekonomik qe ka linje prodhimi dhe perpunimi te inerteve dhe asfalto beton duhet te kete licensat e nevojshme ose kontrat funizimi per material inerteve me nje operator te licensuar, te lidhurave para noterit shoqeruar me dokumentacionin ligjor te linjes se prodhimit dhe perpunimit te inerteve dhe asfalto beton me afat deri ne perfundimin e kontrates. Operatori ekonomik duhet te paraqesi flete analize te leshuar nga nje laborator i certifikuar nga organet kopetente te shtetit shqiptar.”

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Murati D” sh.p.k., rezulton se ky i fundit nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion në lidhje me përmbushjen e këtij kriteri.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1/a e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti

*kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;[...]*”

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”

III.1.4. Ndërsa në nenin 27 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

III.1.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.6. Gjithashtu, kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Nuk mund të lejohet kualifikimi i një operatori ekonomik në rast se ai ka mungesë fizike dokumentacioni dhe nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga vetë autoriteti kontraktor.

III.1.7. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, KPP vëren se, autoriteti kontraktor për disa nga mallrat objekt prokurimi, konkretisht për inerte dhe asfaltobeton ka kërkuar shprehimisht nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës që të paraqesin licencat e nevojshme, nëse janë prodhues apo përpunues të këtyre mallrave, dhe për operatorët e tjerë pjesëmarrës të cilët nuk janë prodhues të këtyre produkteve, duhet të paraqesin kontratë furnizimi me një operator të licensuar, për materialet e mësipërme.

Nisur nga arsyeja e skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor për operatorin ekonomik ankimues, si dhe kërkesa e përcaktuar në dokumentat e tenderit, KPP nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Murati D” sh.p.k. në SPE, konstaton se, ky i fundit nuk ka paraqitur asnjë dokument me anë të të cilit të vërtetojë se ka një kontratë furnizimi me një prodhues të licensuar për produktet e kërkuara nga autoriteti kontraktor në kriterin e mësipërm.

Akoma më tej, vetë operatori ekonomik ankimues si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor dhe në ankesën e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, pranon në mënyrë të shprehur se nuk ka sjellë asnjë dokumentacion për të përmbushur kriterin e mësipërm, konkretisht “...Sa e lexoj unë këtë kërkesë kjo nuk bën fjalë për ne që jemi tregtare të këtyre mallrave, por bën fjalë për operatorin që ka linjë prodhimi dhe përpunimi inert i asfaltbetoni dhe nuk bën fjalë për neve prandaj KVO nuk ka të drejtë të më skualifikojë sepse ne nuk jemi as prodhues as përpunues të inerteve”. Sa më sipër, vlen të sqarohet se autoriteti kontraktor, në dokumentat e tenderit ka përcaktuar se, në rastin kur operatori ekonomik është prodhues apo përpunues i materialeve të mësipërme duhet të paraqesë licensat e nevojshme, ndërsa për operatorët e tjerë pjesëmarrës të cilët nuk janë prodhues të këtyre produkteve, duhet të paraqesin një kontratë furnizimi me një operator të licensuar, të lidhur para noterit, me afat deri në përfundimin e kontratës.

III.1.8. Sa më sipër, nga dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, në asnjë moment nuk vërtetohet dhe nuk dokumentohet fakti se shoqëria “Murati D” sh.p.k. ka një kontratë furnizimi me një prodhues të licensuar për inerte dhe asfaltobeton. Autoriteti kontraktor ka përcaktuar qartësisht në dokumentat e tenderit, se cilat dokumenta duhen paraqitur me qëllim vërtetimin e një fakti të tillë. Në rastin konkret, dokumentacioni i paraqitur nga ana e ankimuesit në këtë procedurë prokurimi, objekt shqyrtimi, nuk është i rregullt dhe për shkak të mangësive, pasi ka mungesë fizike të dokumentacionit kontratë furnizimi me një prodhues të licensuar për inerte dhe asfaltobeton, kërkesa këto të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

III.1.9. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, në rast se, operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në

mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik “Murati D” sh.p.k. mbi arsyet e tjera të skualifikimit të ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron dhe operatori ekonomik ankimues nuk përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Murati D” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-04974-01-24-2019, me objekt, “Blerje material të ndryshme ndërtimi për mirëmbajtjen e rrugëve”, me fond limit 4.124.600 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 04.02.2019, nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Bashkia Berat.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 292 Protokolli**

**Datë 25.02.2019**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

<b>Nënkryetar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Enkeleda Bega</b>	<b>Lindita Skeja</b>	<b>Merita Zeqaj</b>

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**